

I. HYRJE.

Kalimi nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi të tregut të lirë ka rritur gjithmonë e më shumë rëndësinë e studimit dhe vënien e gurëve dekorativ në dispozicion të biznesit vendas e të huaj. Përdorimi i gurëve dekorativ ka marrë përmasa të mëdha në të gjithë territorin e vendit. Një pjesë e mermereve tonë, si mermeri i Muhurit, Kovoshicës, Gjurasis, gëlqerorët pllakorë etj., kanë gjetur përdorimin e tyre edhe në tregjet e Evropës. Numri i bizneseve në shfrytëzimin e gurëve dekorativë, ka ardhur duke u shtuar dhe me një përhapje gjeografike në të gjithë territorin e vendit.

Sot në Shqipëri njihen vendburime mermeri ose gëlqerore të mermerizuar dhe gurë zbukurimi, të cilët përdoren për veshje të jashtme e të brendshme të ndërtesave, për shtrimin e shesheve, etj. Vendburimet më të njohura të gurëve dekorativë mermere janë Muhuri, Kovoshica, Rasfik, Tresh, Kosovë, Dervican, Jorgucat, Shkallë, Ura Vajguore, Zhitom, etj. Mermeret dhe granitet në Shqipëri janë nxjerrë dhe përdorur qysh në kohët më të lashta, me ta janë ndërtuar monumente e statuja të ndryshme.

Këto gurë dekorativ janë të cilësisë së mirë, të bukur në pamjen e jashtme dhe me veti të mira në përpunimin e tyre. Duke u bazuar në lëndën e parë minerale të vendit tonë, mbas viteve 1960 u ngrit dhe u zhvillua me ritme të shpejta industria nxjerrëse dhe përpunuese e mermereve dhe gurëve dekorativë. Për nevoja të ekonomisë së ndërtimit janë shfrytëzuar e shfrytëzohen objekte të rëndësishme mermeri e gurë dekorativë.

Numri i subjekteve të liçensuara për nxjerrjen e gurëve dekorativë, dhe në mënyrë të veçantë të gëlqerorëve, është rritur ndjeshëm dhe me një hapësirë në të gjithë territorin e vendit. Përveç përdorimit si materiale të zakonshme ndërtimi, një pjesë e mirë e llojeve të shkëmbinjve zotërojnë veti të mira e të përshtatshme për zbukurime. Ato kanë ngjyra të çelura e tërheqëse, të cilat shpeshherë ndryshojnë sipas mineraleve përbërëse që marrin pjesë në ndërtimin e tyre. Llojet e ndryshme të mermereve dhe të gurëve dekorativë përdoren gjerësisht në ndërtime, sidomos në zbukurimin e shtëpive, monumenteve, skulptura e vepra të tjera artistike. Mermeri punohet dhe lustron me lehtësi. Kur është i pastër, ka ngjyrë të bardhë. Takohet edhe me ngjyra të tjera, si gri, i verdhë, rozë, i kuqerremtë ose me nuancë të ndryshme të këtyre ngjyrave.

Sot, në Shqipëri janë instaluar me dhjetra sharra prerëse të gurëve dekorativë mermeri, në çdo qytet me një nivel bashkëkohor të përpunimit të tyre. Këto janë një bazë për përpunimin e gurëve dekorativë të vendit, njohja e gjithë tipeve të tyre gradualisht do të hapë rrugën e përdorimit më të gjërë për nevojat e përdorimit vendas e eksport. Kërkesat për to si për tregun e brendshëm ashtu dhe të jashtëm, janë gjithnjë në rritje.

Subjekti "QATO-01" sh.p.k është regjistruar pranë QKB me numër NIPT-ti K69209401C.

Vendi i ushtrimit të aktivitetit është në: BOGOVE Lagjja kryesore, rruga nacionale Berat - Skrapar.

Objekti i veprimtarisë së subjektit është: "Përpunim, prerje dhe lustrim i mermerit dhe gurëve dekorativ".

Administratori i këtij subjekti është Z. Nikolin Qato.

Në bazë të ligjit Nr. 52/2020 Për disa ndryshime në Ligjin Nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuara, subjekti duhet ti nënshtrohet procedurave për pajisje me leje mjedisi të tipit B, përkatësisht me **ID 3.9 Përpunim, prerje dhe lustrim i mermerit dhe gurëve dekorativ.**

Zhvillimi i këtij aktiviteti merr në konsideratë, identifikimin e ndikimeve të mundshme në mjedisin e punës dhe në afërsi të tij si dhe masat e nevojshme teknike dhe organizative që duhen ndërmarrë, për të siguruar që kjo veprimtari të kryhet pa dëmtuar shëndetin e punonjësve si dhe, pa i sjellë dëme mjedisit të zonës si:

- Pa krijuar rreziqe për ujin, ajrin, tokën, florën dhe faunën.
- Pa shkaktuar pengesa nga zhurmat.
- Pa dëmtuar peisazhin.

Zhvillimi i qëndrueshëm i kësaj veprimtarie, vlerësuar nga pikëpamja e ruajtjes dhe e mbrojtjes së mjedisit, është rezultat i disa faktorëve, të cilët janë vlerësuar dhe mbajtur në konsideratë edhe për hartimin e këtij dokumenti.

Të tillë faktorë janë:

- Njohja dhe vlerësimi i dokumentacionit teknik që zotëron ky subjekt.
- Njohja e gjëndjes reale e zhvillimit të kësaj veprimtarie nga pikëpamja e ndikimit në mjedis.
- Analiza e faktorët pozitiv dhe negativ, që influencojnë në treguesit mjedisor.
- Përcaktimi i masave teknike dhe organizative që duhen ndërmarrë për zbutjen dhe/ose eliminimin e ndikimeve negative në mjedis.

II. PËRSHKRIMI I KUADRIT LIGJOR.

- Ligji nr.10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” (i ndryshuar).
- Ligji nr. 16/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” (i ndryshuar).
- Ligji nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”.
- Ligji nr. 9010 datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (i ndryshuar).
- Ligji nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” (i ndryshuar).
- Ligji nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (i ndryshuar).
- Ligji nr. 10 440, datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” (i ndryshuar).
- V.K.M. nr. 435, datë 12.09.20020 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”
- V.K.M. nr.177, datë 31.03.2005 “për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.
- V.K.M. nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”.
- V.K.M. nr. 587 datë 07.07. 2010 “ Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike”.

- VKM nr.419 datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subject te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit dhe të rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetentë deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB”.
- V.K.M. nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin diferencuar të mbetjeve në burim”.
- V.K.M nr. 686 datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave dhe përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore”
- V.K.M. nr.1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”.
- Urdhrin e ministrit nr.146 datë 08.05.2007 “Për miratimin e listës së kuqe të florës dhe faunës”.
- Udhëzimin nr 8 datë 27.11.2007 “ Për nivelin kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”

III. INSTALIMI DHE AKTIVITETET E TIJ.

Aktiviteti i ushtruar nga Personi Juridik “QATO-01” sh.p.k, ka të bëjë me prerjen, përpunimin, lustrimin, dekorimin e mermerit dhe gurëve dekorativ. Përpunimi i gurit dekorativ dhe mermerit përfshin prerjen, zmusimin dhe luçidimin e mermerit të marrë nga miniera apo të importuar, ku ai përgatitet në dimensione të përshtatshme për përdorime të ndryshme, me makineri të specializuara për prerje, zmusim dhe lëmim. Blloqet e mëdha të mermerit ose gurit dekorativ pasi blihen nga klientë të ndryshme sipas nevojave të tregut nëpërmjet vinçit futen në Gader (makineri prerëse me shumë sharra) dhe i nënshtrohet procesit të prerjes. Pasi mbaron procesi i prerjes së bllokut nëpërmjet vinçave meren pllakat e mermerit ose gurit dekorativ dhe depozitohen në një pjesë të kapanonit. Sharra e prerjes së pllakës së mermerit dhe gurit dekorativ, përdoret për prerjen e pllakave në përmasa më të vogla për të ndjekur proceset e tjera në sharrat më të vogla për të plotësuar proceset e prodhimit. Proçesi i prerjes mund të bëhet me prerje të thatë ose me prerje me lagje mesatare. Pllakat e prera janë të pa lëmuara dhe të pazmusuara dhe janë në formate dhe madhësi të ndryshme, zakonisht midis 2-4 m gjerësi. Menjëherë pas këtij proçesi përdoret një prerje tjetër për të marrë pllaka me prerje me dimensione më të vogla (60x30x2 cm). Në disa raste, pllakat do të shiten direkt pa zmusim dhe luçidim.

Të dhënat teknike të makinerive:

1. Sharrë me fuqi 10 KW, për sharrim mermeri dhe gurit dekorativ.
2. Luçiduese mermeri me fuqi 15KW

Zyrat janë pjesë e objektit dhe ndodhen në katin e sipërm të godinës, dhe kanë një sipërfaqe relativisht, rreth 100 m². Gropa e dekantimit është e vendosur pas godinës së zyrës dhe makinerive të punishtes së përpunimit të mermerit dhe gurit dekorativ.

Makineritë dhe pajisjet:

1. Makineri Luçiduese
2. Monolame (makineri prerëse me një sharrë).
3. Gader (makineri prerëse me shumë sharra)
4. Frezë (makineri për skuadrimin e materialit)
5. Elektro-Kompresor
6. Vegla të ndryshme për punën e ustait.



IV. Lëndët e para dhe ato ndihmëse, substancat e tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar nga instalimi.

4.1. Lëndët e para.

Lënda e parë që përdoret për ushtrimin e këtij aktiviteti, përpunim mermeri janë blloqet e mermerit dhe guri dekorativ.

Këto materiale pasi i nënshtrohen procesit të transportit, depozitohen në një vend të përcaktuar në kapanon, dhe janë të vendosura në mënyrë harmonike duke mos penguar punën në repart.

Lëndët ndihmëse:

Lëndet ndihmëse që përdoren për ushtrimin e këtij aktiviteti, punime mermeri dhe guri dekorativ janë energjia elektrike, uji, etj.

4.2. Energjitë që përdoren.

Objekti është i lidhur me rrjetin inxhinjrik dhe atë rrugor, të zonës ku ai gjendet. Pjesë të rëndësishme të rrjetit inxhinjrik janë, ai i :

- ✓ Furnizimit me energji elektrike.
- ✓ Furnizimit me ujë të pijshëm;
- ✓ Shkarkimi i ujrave “të ndotur”;
- ✓ Sistem i mbrojtjes nga zjarri;

a. Furnizimi me energji elektrike.

Energjia elektrike e nevojshme merret nga rrjeti i furnizimit me energji elektrike të zonës, në bazë të kontratës përkatëse me OSSHE e kësaj zone. Brenda objektit është ndërtuar rrjeti shpërndarës që dërgon rrymën elektrike në të gjitha pikat konsumatore të saj. Energjia elektrike përdoret kryesisht për ndriçimin e ambjenteve të punës, rrugëve etj. Fuqia elektrike e instaluar në këtë karrierë është rreth 25 kWh.

b. Furnizimi me ujë.

Furnizimi me ujë të pijshëm bëhet nga rrjeti i furnizimit me ujë të zonës, në bazë të kontratës përkatëse me subjektin që administron ujësjellësin e kësaj njësie administrative. Uji përdoret për plotësimin e nevojave humane të punonjësve dhe njëkohësisht si pjesëmarrës në disa procese pune të përpunimit të mermerit. Për sigurimin e furnizimit të pandërprerë me ujë, veçanërisht gjatë kohës që është në punë linja e përpunimit të mermerit, është instaluar një depozitë uji me vëllim 5 m³. Si pjesë e kësaj depozite është edhe pompa e ujit si dhe rrjeti i shpërndarjes së tij në të gjitha pikat konsumatore.

Gjatë periudhës së punës së veprimtarisë, konsumi i ujit të pijshëm është rreth 15 m³/muaj.

c. Shkarkimi i ujrave “të ndotur”.

Sasi e madhe uji përdoret për ftohjen e makinave të prerjes, zmusimit, kalibrimit dhe ato të luçidimit. Uji që do të dalë nga këto procese, do të mblidhet nëpërmjet kanaleve të posaçme dhe do të depozitohen në gropat e dekantimit të vendosur menjëherë pas godinës së makinerive. Gropa e dekantimit nuk është në formë kaskade dhe siguron tre nivele dekantimi deri në momenti që uji del nga kjo gropë.

Uji pasi do të dekantohet mbetjet e ndryshme të ngura do të dalë dhe shkarkohet në kanal in e afërt të drenazhimit. Ndërsa për llumin/baltën e grumbulluar, në bashkëpunim me pushtetin lokal do të kërkohet një zgjidhje për ta përdorur këtë material sipas nevojave ose për të depozituar në një vendepozitim të mbetjeve të ngurta.

Sipas praktikave bashkohore dhe standarteve, investitorit do t'i sugjeronim që të bënte një trajtim kimik paraprak në gropat e dekantimit përpara se uji të shkarkohet në sistemin e kanalizimive edhe të drenazhimit. Sistemi i trajtimit kimik mund të përfshijë stabilizimin kimik në mënyrë që të sigurohej ripërdorimi i ujit vetëm për ftohjen e makinerive. Baltrat dhe llumrat e mbetura pas stabilizimit kimik të presohen me një makinë të presionit të lartë për të absorbuar ujin, dhe të briketohen si mbetjet të ngurta, e më pas të transportohen ose depozitohen në vendet e posaçme për to.

d. Sistem i mbrojtjes nga zjarri.

Investitori e ka vlerësuar rrezikun e rënies së zjarrit, dhe ka vendosur në pika të ndryshme të ambjentëve të tij të punës, fikse zjarri me shkumë dhe pluhur. Është e këshillueshme që, këto fikse duhet të kontrollohen nga specialistët përkatës të MNZ, për të vlerësuar gjendjen e tyre teknike.

V. BURIMET E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.

Zhvillimi disa vjeçar i aktivitetit të përpunimit, prerje dhe lustrimit të mermerit dhe gurëve dekorativ, ka bërë të mundur identifikimin e disa ndikimeve negative në zonën e zhvillimit të punimeve si dhe në afërsi të saj.

5.1. Shkarkime në ajër.

Grimcat suspense dhe pluhuri janë problemet kryesore lidhur me funksionimin e reparteve të përpunimit të mermerit dhe gurit dekorativ. Teknologjia që është parashikuar të përdoret në këtë investim është ajo me prerje të lagur, në këtë mënyrë niveli i pluhurave do të jetë i vogël. Megjithatë, ka edhe disa rrugë të tjera nga mund të vij prezenca e pluhurave siç janë:

Lëvizja e automjeteve, nga rrugët e pashtruara, stuhitë ose industritë e mundshme që janë afër me këtë shesh ndërtimi.

Mundësi më e madhe e pluhurit në këtë objekt mund të jetë nga lëvizja e mjeteve në rrugën e pashtruar dhe nga erërat e fuqishme.

Investitorit do t'i sugjeronim që të merrte masa për të shmangur sa më shumë të jetë e mundur krijimin e baltrave në pjesën e pasme të objektit.

Sheshi i përpunimit është i shtruar me beton të varfër dhe nuk krijon probleme për baltra e pluhura. Investitorit, i sugjerojmë që të mbjellë pemë në vijën kufizuese të pronës, të përdorë prerjen e lagur, mbledhjen e llumrave që vijnë nga procesi i prerjes.

5.2. Shkarkime në tokë.

Mbetjet e ngurta të prodhuara nga reparti i përpunimit të mermerit dhe gurit dekorativ mund të ndahen në sipas produkteve ose mbetjeve. Në të gjitha rastet mbetjet duhet të depozitohen në përputhje me kërkesat ligjore në varësi të tipit dhe sasisë së mbetjeve.

Shoqëria duhet të respektojë përcaktimet që do të bëhen në Lejen Mjedisore dhe të depozitojë mbetjet e ngurta në vend-depozitim të mbetjeve të ngurta të caktuar nga Bashkia Skrapar. Burimet e gjenerimit të mbetjeve në përpunimin e mermerit dhe gurit dekorativ mund të kategorizohen në:

- a) Zhavor dhe pllakëza të thyera,
- b) Llumra dhe baltra
- c) Të tjera

Në përputhje me rregullat e Komunitetit Europian, zhavori, pllakëzat e thyera dhe pllakëzat e vogla të papërdorshme janë klasifikuar si inerte në kodin me numër (CER 010202 dhe CER 010406), sipas të cilit ato janë formuar nga procesi të prerjes dhe luçidimit, dhe copëzat e pluhurat llogariten në 10 % të materialit fillestar që hyn në proces.

Mbetjet e lëngshme.

Sasi e madhe uji përdoret për ftohjen e makinave të prerjes, zmusimit, kalibrimit dhe ato të luçidimit. Uji që do të dalë nga këto procese, do të mblidhet nëpërmjet kanaleve të posaçme dhe do të depozitohen në gropat e dekantimit të vendosur menjëherë pas godinës së makinerive. Gropa e dekantimit nuk është në formë kaskade dhe siguron tre nivele dekantimi deri në momenti që uji del nga kjo gropë.

Uji pasi do të dekantohet mbetjet e ndryshme të ngurta do të dalë dhe shkarkohet në kanal in e afërt të drenazhimit. Ndërsa për llumin/baltën e grumbulluar, në bashkëpunim me pushtetin lokal do të kërkohet një zgjidhje për ta përdorur këtë material sipas nevojave ose për të depozituar në një vendepozitim të mbetjeve të ngurta.

Sipas praktikave bashkohore dhe standarteve, investitorit do t'i sugjerohet që të bënte një trajtim kimik paraprak në gropat e dekantimit përpara se uji të shkarkohet në sistemin e kanalizimit edhe të drenazhimit. Sistemi i trajtimit kimik mund të përfshijë stabilizimin kimik në mënyrë që të sigurohet ripërdorimi i ujit vetëm për ftohjen e makinerive. Baltrat dhe llumrat e mbetura pas stabilizimit kimik të presohen me një makinë të presionit të lartë për të absorbuar ujin, dhe të briketohen si mbetje të ngurta, e më pas të transportohen ose depozitohen në vendet e posaçme për to.

5.3. Shkarkime të ujrave të ndotur.

Cilësia e ujrave që do të dalin nga proceset teknologjike në këtë repart të përpunimit të mermerit dhe gurit dekorativ do të plotësojë kërkesat e ligjit Për trajtimin mjedisor të ujrave të ndotur dhe VKM Nr. 177, datë 31.03.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse."

Eksperinca dhe të dhënat e mbledhura nga studime të bërë në vende të ndryshme tregojnë se shkarkimet ujore të instalimeve të tilla siç është reparti i përpunimit të mermerit dhe gurit dekorativ përmbajnë përqendrime të këtyre elementeve Ca, Mg, K, SO₄ dhe në raste të veçanta Na.

Rekomandimi që bëme për investitorin, ishte që të përdorte stabilizues në gropën e dekantimit. Një lloj stabilizuesi gjerësisht i përdorur është edhe agjenti flokulues i njohur si PRAESTOL 2540 TR, për të flokuluar tretësirën koloidale të Karbonatit të Kalciumit në gropën dekantuese.

Rekomandohet që përdorimi miqësor me mjedisin i këtij flokuluesi të bëhet në përqëndrimin 0.05-01%.

Në përputhje me rregulloret e komisionit europian, ujrat e ndotur me këto përmbajtje janë klasifikuar si jo të rrezikshme me kodin (CER 01045), nëse përqëndrimi i këtyre kimikateve nuk e kalon vlerën e lejuar (2000 mg/kg).

5.4. Shkarkime të zhurmave.

Aktiviteti në këtë repart duhet të respektojë legjislacionin specifik për zhurmat: Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2008 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” dhe udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Shëndetësisë Nr. 8, datë 27.11.2008 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara.” Megjithatë, objekti nuk është vendosur në zonë të populluar. Niveli i zhurmave të shkaktuara nga trafiku do të jetë më i lartë se i ai i shkaktuar nga operimi i makinerive në repartin e përpunimit të mermerit dhe gurit dekorativ. Sidoqoftë, investitorit do ti rekomandonim që në zgjedhjen e makinerive të ketë parasysh që të jenë makineri me shuarës zhurmash. Për punonjësit e repartit duhet të merren masa që të jenë të mbrojtur nga zhurmat dhe të mos ekspozohen me shumë se dy orë në mënyrë të vazhdueshme. Për investitorin sugjerojmë që të parshikojë një program vizitash periodike tek mjeku otorinolog, dhe brenda sallës së makinerive të instalojë një pajisje audiometrike dhe sinjalizuese për zhurmat.

VI. KUSHTET NË VENDNDODHJEN E INSTALIMIT DHE, RASTET E NJOHURA HISTORIKE TË NDOTJES.

Subjekti “QATO-01” sh.p.k me NIPT K69209401C, ushtron veprimtarinë e përpunimit, prerjes dhe lustrimit të mermerit dhe gurëve dekorativ në BOGOVE Lagjja kryesore, rruga nacionale Berat – Skrapar.



Objekti në të cilin zhvillohet veprimtaria e këtij subjekti, gjendet në Bogovë, Skrapar. Është një objekt i rikonstruktuar dhe i përshtatur me veprimtarinë që zhvillohet këtu. Ai është i përfshirë brenda koordinatave të pasqyruara në tabelën e mëposhtme sipas sistemis Gauss-Kruger WGS84:

Nr. i pikës	X	Y
1	4427475.330	4493909.531
2	4427640.864	4493764.272

3	4427630.908	4493750.663
4	4427480.944	4493836.657

Skrapari shtrihet në Shqipërinë J, në pjesën VL të Krahinës Malore Jugore. Përfshin: 2 qytete, Çorovoda qendër e rrethit dhe Poliçani. Dendësia mesatare 54,8 bahorë km², popullsia në qytet 30,1%, në fshat 69,9%. Rritja natyrore 2,24%.

Mbizotëron relievi malor e kodrinor. Lartësia mesatare 788 m. Zonat më të ngritura malore janë Tomorica, Kulmaku ku ndodhen pikat më të larta të rrethit: maja e Tomorit (2416 m), maja e Kulmakut (2173 m) dhe zona e Potomit. Vendet e ulëta shtrihen përgjatë luginës së Osunit, Luginat kryesore: e Osunit e Tomoricës dhe e Çorovodës. Lumenjtë: Osumi pjesërisht rrjedha e sipërme dhe e mesme, Tomorica rrjedha e sipërme dhe pjesërisht e poshtme, Çorovoda, Malindi, Stravecka etj. Klima është mesdhetare, kodrinore e malore. Temp. mesatare vjetore 12.9°, mesatarja e muajve më të ftohtë 6.4° dhe më të ngrohtë 23°C. Temp. absolute më e ulët-13.7°, më e larta 41.4°C. Sasia mesatare vjetore e reshjeve 1285 mm, pjesa më e madhe në stinën e dimrit. Era lokale më karakteristike është Stoçeni (murlani, e fortë dhe e ftohtë, sidomos në dimër, fryn në zonën e Tomoricës dhe të Potomit në drejtim VL e JL). Tokat bujqësore janë kryesisht të kafenjta malore 52%, të hirta kafe 31% etj. Pyjet dhe shkurret zënë 31% të sipërfaqes, kullotat 38.3%. Ka një rezervat gjuetie. Burimet nëntokësore kryesore: Guaku, Bogova, Varishti, Ujaniku etj. Rrethi i Skraparit është rreth bujqësor-industrial. Bujqësia jep 48% të prodhimit të përgjithshëm shoqëror. Kolektivizimi i bujqësisë filloi më 1955. Sipërfaqja e punueshme zë 15.2% të rrethit, nga e cila 84.4% e zënë bimët e arave, 12.6% frutikultura, 2.6% vreshtat. Sot ujiten 24.5% e tokës së punueshme, ka 15 ujëmbledhës, si në Vendreshë, Prishtë, Potom, Mollas etj. Janë të mekanizuara 65% e plugimeve, 12% e prashitjeve, 40% e korrjeve, 100% e shirjeve etj.



Kulturat kryesore: gruri (47% të sipërfaqes), misri (15%). Më 1938 rendimenti mesatar ishte 5 kv/ha grurë, sot është 23.4 kv/ha. Rrethi i Skraparit përmendet për prodhimin e rrushit nga pjergullat e vreshtat, të fiqve, qershive, mollëve, kajsive, arrave, kumbullave. Në blegtori mbizotërojnë dhentë dhe dhitë. Ka bletari të zhvilluar.

Industria jep 33% të prodhimit të përgjithshëm shoqëror, është zhvilluar me vrull në vitet e pushtetit popullor dhe gjatë pesëvjeçarëve janë ndërtuar një varg veprash të mëdha. Para Çlirimit nuk kishte asnjë punishte. Më 1983 prodhimi industrial ishte 27 herë më i madh se në

1950 dhe 16.7 herë në krahasim me vitin 1960. Dega kryesore e industrisë është industria ushqimore që jep 54.9% të prodhimit industrial të rrethit, sidomos fabrika e përpunimit të rrushit dhe ajo e përpunimit të qumështit. Janë zhvilluar industritë e lëndëve të ndërtimit, e përpunimit të drurit, industria mekanike etj. Në Rrethin e Skraparit përfshihen pjesë nga zonat etnografike: Tomorica, Potomi, Malindi, Çepani etj. Rrethi ka tradita për punimin e drurit, të rrushit për raki, verës e rehanisë, për qëndistarinë etj.

VII. NATYRA DHE SASITË E SHKARKIMEVE TË PRITSHME NGA INSTALIMI NË ÇDO VEND/MJEDIS, SI DHE IDENTIFIKIMI I EFEKTEVE TË RËNDËSISHME TË SHKARKIMEVE NË MJEDIS.

Ekspierienca disa vjeçare e veprimtarisë së përpunimit, prerjes dhe lustrimit të mermerit dhe gurëve dekorativ, ka treguar se kemi shkarkime të përkohëshme në ajër, gjenerim të zhurmave si dhe, menaxhimit të mbetjeve të ngurta teknologjike përfshirë këtu edhe të mbetjeve urbane.

7.1. Natyra dhe sasitë e shkarkimeve të pritëshme, në mjedis.

a. Shkarkime në ajër.

Grimcat suspense dhe pluhuri janë problemet kryesore lidhur me funksionimin e reparteve të përpunimit të mermerit dhe gurit dekorativ. Teknologjia që është parashikuar të përdoret në këtë investim është ajo me prerje të lagur, në këtë mënyrë niveli i pluhurave do të jetë i vogël. Megjithatë, ka edhe disa rrugë të tjera nga mund të vij prezenca e pluhurave siç janë:

Lëvizja e automjeteve, nga rrugët e pashtuara, stuhitë ose industritë e mundshme që janë afër me këtë shesh ndërtimi.

Mundësi më e madhe e pluhurit në këtë objekt mund të jetë nga lëvizja e mjeteve në rrugën e pashtuar dhe nga erërat e fuqishme.

Investitorit do t'i sugjeronim që të merrte masa për të shmangur sa më shumë të jetë e mundur krijimin e baltrave në pjesën e pasme të objektit.

Sheshi i përpunimit është i shtruar me beton të varfër dhe nuk krijon probleme për baltra e pluhura. Investitorit, i sugjerojmë që të mbjellë pemë në vijën kufizuese të pronës, të përdorë prerjen e lagur, mbledhjen e llumrave që vijnë nga procesi i prerjes.

b. Gjenerimi i zhurmave.

Aktiviteti në këtë repart duhet të respektojë legjislacionin specifik për zhurmat: Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2008 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis" dhe udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Shëndetësisë Nr. 8, datë 27.11.2008 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara." Megjithatë, objekti nuk është vendosur në zonë të populluar. Niveli i zhurmave të shkaktuara nga trafiku do të jetë më i lartë se i ai i shkaktuar nga operimi i makinerive në repartin e përpunimit të mermerit dhe gurit dekorativ. Sidoqoftë, investitorit do ti rekomandonim që në zgjedhjen e makinerive të ketë parasysh që të jenë makineri me shuarës zhurmash. Për punonjësit e repartit duhet të merren masa që të jenë

të mbrojtur nga zhurmat dhe të mos ekspozohen me shumë se dy orë në mënyrë të vazhdueshme. Për investitorin sugjerojmë që të parshikojë një program vizitash periodike tek mjeku otorinolog, dhe brenda sallës së makinerive të instalojë një pajisje audiometrike dhe sinjalizuese për zhurmat.

c. Menaxhimi i mbetjeve të ngurta teknologjike dhe mbetjeve urbane.

Mbetjet e ngurta të prodhuara nga reparti i përpunimit të mermerit dhe gurit dekorativ mund të ndahen në sipas produkteve ose mbetjeve. Në të gjitha rastet mbetjet duhet të depozitohen në përputhje me kërkesat ligjore në varësi të tipit dhe sasisë së mbetjeve.

Shoqëria duhet të respektojë përcaktimet që do të bëhen në Lejen Mjedisore dhe të depozitojë mbetjet e ngurta në vend-depozitim të mbetjeve të ngurta të caktuar nga Bashkia Skrapar.

Burimet e gjenerimit të mbetjeve në përpunimin e mermerit dhe gurit dekorativ mund të kategorizohen në:

- a) Zhavor dhe pllakëza të thyera,
- b) Llumra dhe baltra
- c) Të tjera

Në përputhje me rregullat e Komunitetit Europian, zhavori, pllakëzat e thyera dhe pllakëzat e vogla të papërdorshme janë klasifikuar si inerte në kodin me numër (CER 010202 dhe CER 010406), sipas të cilit ato janë formuar nga procesi të prerjes dhe luçidimit, dhe copëzat e pluhurat llogariten në 10 % të materialit fillestar që hyn në proces.

Mbetjet e tjera/urbane hidhen çdo ditë në kazanët e mbetjeve urbane të qëndrës së banuar dhe largohen prej aty, për në sheshin e depozitimit të mbetjeve urbane, nga një subjekti përkatës i caktuar.

d. Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës ku zhvillohet projekti.

Nuk vlerësohen ndikime negative në karakteristikat fizike të zonës ku zhvillohet kjo veprimtari. Në këtë zonë, ndërhyrjet fizike për ndërtime godinash, rrjetesh inxhinjerie, rrugësh etj. janë të përfunduara. Në periudha të përcaktuara, kryhen punime për mirëmbajtjen e këtyre ndërtimeve inxhinjerie, sigurisht mbështetur në lejet ndërtimore të miratuara nga pushteti vendor.

e. Ndikimet negative në habitatet dhe biodiversitetin e zonës ku zhvillohet projekti.

Nga zhvillimi i këtij aktivitet nuk dëmtohet flora dhe fauna e rrezikuar e cila është përcaktuar në V.K.M-në Nr. 804.dt. 04.12.2003

Zona që shfrytëzohet nuk përfaqëson zonë me rëndësi të veçantë dhe për këtë arsye nuk është parashikuar sipas Strategjisë për "Ruajtjen e Biodiversitetit dhe Planit të Veprimit si Zonë e Mundshme" për t'u shpallur "Peisazh i mbrojtur".

f. Ndikime sociale nga zhvillimi i projektit të tilla si ndryshimi i përdorimit të tokës dhe burimeve të tjera natyrore si dhe, shqetësime që mund të lindin nga ndikimet në mjedis për shkak të shkarkimeve të ndryshme, zhurmave, rënies së zjarreve etj.

Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ka kërkuar dhe nuk do të kërkojë përdorimin e tokës shtesë veç asaj të miratuar për shfrytëzim.

Probabiliteti i ndodhjes për secilin nga rastet e mësipërm do të varet shumë nga masat mbrojtëse që janë parashikuar të zbatohen.

Zhvillimi i aktivitetit të përpunimit, prerjes dhe lustrimit të mermerit dhe gurëve dekorativ nuk shoqërohet me aksidente mjedisore të cilat mund të sjellin pasoja të dëmshme në treguesit cilësor të mjedisit të vendit ku ponohet dhe në afërsi të tij si:

- ndotje të ujërave nga lëndë të rrezikshme,
- emetime në ajër të gazeve helmuese
- kontaminim të tokës.

7.2. Karakteristikat e ndikimeve negative dhe efektet e rëndësishme të tyre në mjedis.

a. Vlerësimi i ndikimeve.

Proçesi i vlerësimit të ndikimeve negative në mjediset e vendeve të punës dhe në zonën rreth tyre, është i lidhur me kryerjen e një sërë njohjesh dhe vlerësimesh të tilla si:

- Njohja e vlerave natyrore dhe mjedisore të zonës.
- Njohja me infrastrukturën inxhinjerieke egzistuese dhe me nevojën për plotësim të saj me infrastrukturë të re në plotësim të kërkesave që parashtron projekti që zbatohet.
- Njohja me lëndët e para dhe ato ndihmëse si dhe me energjitë e nevojshme që përdoren për zbatimin e projektit.

Mbështetur mbi këto të dhëna bazë si dhe, në treguesit mjedisor të subjektit të dalë gjatë punës disa vjeçare të tij, ekspertë të fushave të ndryshme bënë përpjekje për të përcaktuar vlerësime të identifikuar. Vlerësimi i kryer ka të bëjë me efektet e tyre të drejtpërdrejta apo të tërthorta në treguesit cilësor të mjedisit, në zonën ku zhvillohet projekti dhe është një nga fazat më të rëndësishme për zbatuesit e projektit sepse:

- Tregon llojin, elementët dhe kohëzgjatjen e çdo lloj ndikimi të identifikuar.
- Përafron ato me objektivet me tërësinë e bashkëveprimeve të tyre me parametrat mjedisor të zonës ku zhvillohet projekti.

Kriteret e përdorur për vlerësimin e ndikimeve variojnë dhe përcaktohen nga faktorë të përcaktuar dhe rezultatet e arritura drejtohen kryesisht ndaj përmirësimeve më të mundshme të vlerave të mjedisit të ndikuar.

b. Shtrirja fizike e ndikimeve negative.

Ky parametër vlerëson sipërfaqen apo dimensionet hapësinore të shtrirjes së një ndikimi të përcaktuar e vlerësuar në raport me burimin që gjeneron këtë ndikim.

c. Kohëzgjatja e ndikimeve negative.

Ky parametër vlerëson periudhën kohore se sa mund të zgjasë një ndikim i caktuar në dimesionin kohor dhe kështu mund të kemi ndikim të përhershëm/mbetës apo ndikim të përkohshëm.

Grimcat suspense dhe pluhuri janë problemet kryesore lidhur me funksionimin e reparteve të përpunimit të mermerit dhe gurit dekorativ. Teknologjia që është parashikuar të përdoret në këtë investim është ajo me prerje të lagur, në këtë mënyrë niveli i pluhurave do të jetë i vogël.

d. Kthyeshmëria

Ky parametër vlerëson të gjitha mundësitë e kthimit të mjedisit të ndikuar, në gjendjen e tij të mëparshme apo/ose aftësitë për rehabilitimin dhe rigjenerimin e plotë të mjedisit të ndikuar.

e. Rëndësia.

Ky parametër realizon një vlerësim total të të gjithë përmasave të mësipërme dhe njëkohësisht thekson e rekomandon drejtimit më të rëndësishme që duhet ndjekur dhe zbatuar nga drejtuesit e subjektit, për të administruar saktësisht çdo lloj ndikimi të identifikuar.

f. Llojet e ndikimeve të identifikuar (direkte dhe jodirekte).

Ndikimet e identifikuar nga zhvillimi i aktivitetit të lysterjeve të automobilave, janë ndikime të drejtpërdrejta në mjedis.

VIII. TEKNOLOGJIA DHE TEKNIKA TË TJERA TË PROPOZUARA PËR PARANDALIMIN E SHKARKIMEVE OSE, KUR KJO NUK ËSHTË E MUNDUR, PËR PAKËSIMIN E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI, VEÇANËRISHT DUKE ZBATUAR TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME.

Duke vlerësuar në tërësi, të dhënave teknike të pajisjeve dhe sistemeve të instaluar në këtë linjë teknologjike, gjykojmë se ato duhet të realizojnë qëllimin për të cilën janë vendosur dhe funksionojnë në këtë proces teknologjik. Vënia plotësisht në punë e tyre për një periudhë relativisht të gjatë kohe, si dhe kryerja e monitorimeve respektive minimalisht çdo gjashtë muaj, do të reflektojnë rezultate, analiza e të cilave do të dëshmojë për:

- i. Përputhshmërinë e plotë apo të pjesshme të punës së tyre me linjën teknologjike si dhe kërkesat e standartit për shkarkimet në mjedis;
- ii. Nevojën për ndryshime të parametrave teknologjik apo për ndryshime konstruktive.

Vlerësimi i përgjithshëm i zhvillimeve në këtë veprimtari dëshmon se të gjitha llojet e shkarkimeve janë të përkohshme. Treguesit cilësor të lëndëve që shkarkohen si dhe sasitë respektive të secilës prej tyre nuk kanë influenca mbetëse në cilësinë e mjedisit dhe nuk mund të çojnë më tej në përqendrim të treguesve cilësor aktual të mjedisit.

IX. ALTERNATIVËN NË LIDHJE ME ZGJEDHJEN E VENDIT TË INSTALIMIT DHE TEKNOLOGJINË E PËRDORUR.

Disa prej përparësive të zgjedhjes së këtij trualli po i pasqyrojmë në vijim:

- Gjendet në një zonë me infrastrukturë inxhinjrike të plotësuar.
- Është e lidhur organikisht me rrjetin rrugor kombëtar.
- Gjenden lehtësisht persona të arsimuar dhe kualifikuar për të kryer proceset e punës, të programuar nga kjo veprimtari.

Pajisjet e instaluara si dhe parametrat teknologjikë me të cilët punojnë këto pajisje, besojmë se janë bashkëkohore, nisur nga fakti që ato vijnë nga vende të BE-së.

X. MASAT PËR PARANDALIMIN DHE RIKUPERIMIN E MBETJEVE (NËSE ËSHTË E NEVOJSHME).

Drejtnesit teknik d'helgjor të subjektit i kanë kushtuar vëmendje maksimale eliminimit të të gjitha llojeve të mbetjeve të krijuara nga kjo veprimtari. Në vijim po përshkruajmë mënyrat apo procedurat që zbatohen në trajtimin e mbetjeve të krijuara.

- a. Mbetje e teknologjike të ngurta, që dalin gjatë proceseve të prerjes, kontrollit teknik etj.

Mbetjet e ngurta të prodhuara nga repart i përpunimit të mermerit dhe gurit dekorativ mund të ndahen në sipas produkteve ose mbetjeve. Në të gjitha rastet mbetjet duhet të depozitohen në përputhje me kërkesat ligjore në varësi të tipit dhe sasisë së mbetjeve.

Shoqëria duhet të respektojë përcaktimet që do të bëhen në Lejen Mjedisore dhe të depozitojë mbetjet e ngurta në vend-depozitim të mbetjeve të ngurta të caktuar nga Bashkia Skrapar.

Burimet e gjenerimit të mbetjeve në përpunimin e mermerit dhe gurit dekorativ mund të kategorizohen në:

- a) Zhavor dhe pllakëza të thyera,
- b) Llumra dhe baltra
- c) Të tjera

Në përputhje me rregullat e Komunitetit Europian, zhavori, pllakëzat e thyera dhe pllakëzat e vogla të papërdorshme janë klasifikuar si inerte në kodin me numër (CER 010202 dhe CER 010406), sipas të cilit ato janë formuar nga procesi të prerjes dhe luçidimit, dhe copëzat e pluhurat llogariten në 10 % të materialit fillestar që hyn në proces.

- b. Mbetje urbane të cilat përbëhen nga ambalazhe të letrës, kartonit, plastikës, qelqit, drurit, mbetje ushqimore nga veprimtaria njerzore etj.

Të vetmet lëndë të ngurta që gjenerohen janë ambalazhe plastike, kartoni, letre si dhe mbetje urbane. Mbetjet urbane hidhen çdo ditë në kazanët e mbetjeve urbane të qëndrës së banuar dhe largohen prej aty, për në sheshin e depozitimit të mbetjeve urbane, nga një subjekti përkatës i caktuar.

XI. MASAT PËR PËRDORIMIN EFIÇENT TË ENERGJISË.

Të gjitha makineritë, pajisjet e instaluara në këtë subjekt janë blerë në vende të Bashkimit Europian. Janë pajisje bashkëkohore me sisteme të komandimit individual të punës së tyre, sepse i tillë është edhe operacioni i punës së tyre. Kështu çdo njëra prej tyre punon sa kohë është e nevojshme dhe gjatë gjithë kohës tjetër qëndron pa punuar pa cënuar punën e pajisjeve dhe makinerive të tjera. Kjo mënyrë shfrytëzimi bën të mundur kontrollin rigoroz të punës së tyre dhe për rrjedhojë edhe një konsum energjie të kontrolluar në nivelet më të pranushme. Të gjitha këto dëshmojnë për një punë normale të elektromotorrëve që vënë në lëvizje këto pajisje dhe për shfrytëzim eficient të energjisë elektrike.

Sistemi i ndriçimit të ambjenteve të punës është i plotësuar me pajisje ndriçimi ekonomike, duke krijuar edhe këtu kushte për një shfrytëzim eficient të energjisë elektrike.

XII. MASA TË TJERA TË PLANIFIKUARA NË PËRPUTHJE ME PARIMET E PËRGJITHSHME QË RREGULLOJNË DETYRIMET THEMELORE TË OPERATORIT, DMTH:

- a. Janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre.

Subjekti ka një periudhë relativisht të gjatë kohe që ushtron këtë veprimtari, në shfrytëzimin e linjave teknologjike përkatëse. Kështu duhet të pranojmë që personeli punojës ka fituar eksperiencën e mjaftueshme në realizimin e prodhimeve të përcaktuara si dhe në shfrytëzimin e makinerive dhe pajisjeve teknologjike. Janë hartuar rregullat për shfrytëzimin e këtyre makinerive dhe pajisjeve teknologjike si dhe ato të mbrojtjes në punë.

Ne vlerësojmë se është e nevojshme plotësimi i këtyre rregulloreve me ato të mbrojtjes nga zjarri si dhe të manovrimeve që duhet të kryhen në rastet e ndodhjes së aksidenteve të ndryshme, teknike e teknologjike.

Krahas tyre duhet të vijojë trajnimi i punonjësve të këtij subjekti për njohjen e plotë të të gjitha rregulloreve të hartuara.

- b. Janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme.

Është kryer një investim i rëndësishëm në disa drejtime si, në infrastrukturën inxhinjerie (ndërtesë, rrjete inxhinjerie etj) instalimin e linjave teknologjike dhe në trajnimin e personelit punonjës.

Të gjitha këto me idenë e një zhvillimi të qëndrueshëm, si nga ana financiare ashtu edhe në prespektivën kohore të zhvillimit të tij. Drejtuesit e subjektit nuk mendojnë akoma për të vlerësuar ndërprerjen e zhvillimit të këtij aktiviteti dhe për këtë arsye nuk kanë hartuar programet që do të zbatohen për mbylljen e kësaj veprimtarie.

Egziston një përvojë pozitive në ndërprerjet e përkohshme të aktivitetit prodhues në këtë linjë teknologjike. Këto ndërprerje janë të zakonshme, nisur nga organizimi i punës vetëm me një turn dhe me ditë pushimi javor dhe të të gjithë festive zyrtare.

Mbyllja përfundimtare ka kërkesa më rigorozë të cilat kërkojnë gjithashtu procedurë të përcaktuara saktësisht, për çdo stad zhvillimi të proceseve që duhen kryer për mbylljen e aktivitetit. Kështuqë, kërkohen studime të plota nga grupe inxhinjerësh apo ekspertësh të fushave të ndryshme, të kryera në përputhje me kërkesat e legjislacionit finaciari, mjedisor, të administrimit të teritorit, të efekteve sociale etj. Krahas kryerjes së këtyre studimeve, duhet të përgatitet dokumentacioni përkatës për marrjen e lejeve të nevojshme, si psh vendi ku do të hidhen mbeturinat që do të krijohen, metalike, plaste, inertesh etj. Çdo të bëhet me truallin pas lirit të tij, do të vijojë të qëndrojë si një truall për përdorim industrial apo do përshtatet për veprimtari të tjera!?

Duke vlerësuar kërkesat e kësaj rubrike, ne mund të pohojmë se ndërpreja e kësaj veprimtarie nuk sjell pasoja në ndjeshme në treguesit mjedisor të zonës ku ai zhvillohet.

Nëse mbyllet kjo veprimtari atëherë do të hiqen të gjitha pajisjet e instaluar. Godina do të qëndrojë në gjendjen e tanishme apo mund të përshtatet rishtas për zhvillimin e ndonjë aktiviteti tjetër.

XIII. MONITORIMI I PLANIFIKUAR I SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.

Monitorimet duhet të kryhen nga laboratorë të akredituar për vlerësimin e shkarkimeve në mjedis, në përputhje me kërkesat e legjislacionit respektiv, për shkarkimet në ajër dhe nivelin e zhurmave.

Parametri	Frekuenca e monitorimit	Metoda/teknika e analizës
Ndotës të ngurtë	Çdo 6 muaj	Sipas standartit
Ndotës i gaztë	Çdo 6 muaj	Sipas standartit
Zhurmat	Çdo 6 muaj	Sipas standartit

Laborator i Akredituar
Gjithmone pranë jush!

- FUND -

